

Domosdoshmëria e Edukimit medial

Mediat janë fuqizuar aq shumë, saqë ndikimi i tyre llogaritet të jetë i pakrahasueshëm. Së këndejmi, bie poshtë mundësia që do të përfundojë periudha e tyre, apo të ulet ndikimi. Kështu, krejt çfarë duhet të bëjnë studiuesit e shkencave të komunikimit, është që të krijojnë metoda të mbrojtjes nga mediat.

Në pikën që jemi ne, edukimi medial shihet si mjete më i afërt që bën audience të jetë aktive, dhe në këtë mënyrë të filtrojë gjithë mesazhet që merr. Pra, të shoh me dyshim çdo përmbajtje mediatike.

Më tej, duhet të thuhet se roli pozitiv i mediave as duhet diskutuar. Por, ky rol ka ndikuar që ato të fuqizohën, e pastaj të përdoren dhe negativisht. Këtu lind nevoja për edukimin edhe në sferën mediale.

Në këtë tekst mijëraffalësh, tentohet të ripotencohet efekti pozitiv i medias; gjithashtu të tregohet që mediat mund të përdoren edhe për të keq. E si rrjedhojë e kësaj, synojmë të argumentojmë nevojën për një lëndë të re në kurrikulën e arsimit në Kosovë – atë të Edukimit medial



Të mirat që vijnë nga mediat

Kur një ngjarje raportohet në media, ajo merr një jetë të re. Jetëgjatësia e saj më pas varet nga mënyra se si mediat vendosin ta trajtojnë atë ngjarje.

Se sa është i rëndësishëm raportimi i mediave për tema të ndryshme, më së miri e tregon fakti se gjithandej botës, mediat çdo ditë e më shumë po e forcojnë rolin e tyre.

Raportimi në media për ngjarje të mëdha e në të njejtën kohë edhe shumë të ndjeshme, është shumë i rëndësishëm, e sidomos qasja e mediave ndaj atyre ngjarjeve.

Kujtojmë luftën e viteve 1998-1999 në Kosovë, kur kudo nëpër botë u raportua për atë se çfarë po ndodhte në Kosovë.

Për këtë ngjarje në botë ekzistonin dy realitete të ndryshme: ajo që shteti serb e quante luftë për mbrojtjen e territorit të vet, ndërkaq në anën tjetër, atë të realitetit shqiptar, kjo luftë ishte një spastrim etnik.

Për pasyrimin e të vërtetës lidhur me këtë luftë, dhe për sqarimin e opinionit, një rol të rëndësishëm e luajtën mediat.

Me anë të artikujve e pamjeve që u publikuan në mediat e mëdha botërore si BBC, Reuters e “Evropa e Lirë”, u bë i qartë imazhi i vërtetë i dhunës dhe i masakrave serbe në Kosovë.

Të gjitha vendet pjesmarrëse në bombardimet e NATO-s, e kishin përkrahjen e qytetarëve të tyre, kjo pasi që u kuptua se në Kosovë po bëhej luftë e padrejtë. E për t’u kuptuar kjo, rol determinues ka luajtur raportimi i mediave. Dhe, duke e ditur se këto vende nuk mund të vepronin pa vullnetin e qytetarëve të tyre, dhe ishte pikërisht raportimi i mediave që i bindi, tregon rolin e rëndësishëm të mediave.

Përveç kësaj, presidenti i atëhershëm i SHBA-ve, Bill Clinton, pati thënë se, pasi i kishte parë disa nga pamjet e luftës në Kosovë në televizion, ku shiheshin turma refugjatësh që linin vendin e tyre, e kishte kuptuar qartë se çfarë po ndodhte atje.

Edhe tash 17 vite pas rastit të lartpërmendur, ndikimi i medias u forcua edhe më shumë, kjo për shkak të avansimit të teknologjisë, gjë që ia rrit ndikimin medias online, dhe e cila u jep jehonë më të madhe ngjarjeve të ndryshme e të rëndësishme për shoqërinë.

I freskët është rasti i fëmijut sirian Alyan Kurdi. Ai ishte një tre vjeçar sirian, i cili së bashku me familjen dhe një numër refugjatësh ishin nisur të kalonin përmes detit nga Turqia në Greqi, ku edhe kishin humbur jetën. Fotoja e trupit të vdekur të fëmijës ishte publikuar në media kudo në botë.

Për luftën në Siri u shkruan me qindra artikuj, mirëpo asnjëri nga këta nuk e pati fuqinë e ndikimit si publikimi i fotografisë dhe shkrimit për fëmijun Alyan Kurdi.

Pas raportimit të këtij rasti shtetet evropiane ndërruan qasje ndaj refugjatëve sirian, duke ua hapur dyert.

Kryeministri i Britanisë së Madhe, David Cameron në lidhje me këtë foto kishte thënë:

“Çdokush që e ka parë atë foto nuk mund të ndihmonte brenda natës, por si një baba, jam ndjerë thellësisht i pikëlluar nga pamja e atij djaloshi në bregdetin e Turqisë... Britania është një komb moral dhe ne do t'i përbushim obligimet tona morale.” (Dathan, 2015)

Të dy shembujt që i përmendëm përbrenda kanë hasur në kritika, janë akuzar për shkelje të kodeve etike, sepse brenda tyre kanë pasur si personazhe kufoma fëmijësh, dhe jo vetëm. Por, ndikimi pozitiv që këto raste, ka qenë shumë më i madh sesa dëmi që ato mund të shkaktonin. Mënyra se si mediat i trajtonë ngjarjet, sidomos të tilla si këto që po i përmendim, mund të jetë shumë e dobishme, dhe të shpie në përmirësim të gjendjes, gjë që nuk do të bëhej pa ndikimin medial.

Fuqia e medias po rritet për shkak të përsosshmërisë së teknologjisë, ku shkrimit i bashkohen fotografi e video, dhe të cilat po i japin mundësi raportimit të jetë më i fuqishëm dhe më ndikim.

Rastet që ne i përmendëm janë ato që zgjuan ndërgjegjen dhe përgjegjësinë gjithëshoqërore.



Por, jo vetëm kaq. Në Kosovë shpesh shohim lajme përmes te cilave kërkohet ndihmë, si në aspektin e sëmundjeve te cilat kanë një kosto te kushtueshme, e po ashtu edhe ne rastet e familjeve të cilat nuk kanë as kulm mbi kokë. Këto raportime shpesh kanë çuar në veprime të mira nga qytetarë të cilët nuk kanë hezituar të kontribuojnë në ndihmë të këtyre rasteve.

Jo rrallë herë shohim raste të familjeve të cilat nuk kanë mundësi t'i shërojnë anëtarët e tyre të familjes nga sëmundjet të cilat kanë një kosto të lartë për shërim. Rasti i korrespondentit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), Sulejman Gashi, ku gjatë edicionit të lajmeve ishte raportuar se familja e gazetarit Sulejman Gashi kërkon ndihmë, pasi që transporti i gazetarit nga qytetin Salt Lake City në Utah ne Neë York(bartja me nje aeroplan special) bashkë me një ekip të mjekëve të trajtimit intensiv, kushtonte rreth \$50,000, të cilat familja nuk i posedonte. Ende pa kaluar njëzet e katër orë nga apeli i familjes për ndihmë, janë grumbulluar \$59,000, të nevojshme për transportin e tij në Neë York.


Pas raportimit në Radio Televizionit Njëzet e një (21) në emisionin “Edhe Unë Jam Kosovë” për gjendjen e rëndë të familjes Bytyqi nga Sllovija e Komunës së Lipjanit, kishte prekur ndërgjegjen e qytetarit Safet Azizi, i cili me familjen e tij nga diaspora, kishin vendosur që t’ia ndërtojnë shtëpinë e re kësaj familje. Pra, shpesh raportimet e tilla kanë quar në vepra të mira, e këtë e dëshmon edhe vet fakti se vetëm nga ky emision ku janë raportuar raste të shumta, janë ndërtuar më shumë se 200 shtëpi.



Pra, raportimi i mediave ka bërë që të ndrrohen përceptimet për luftën në Kosovë, çka mund të llogaritet si një ndikim vështirë i arritshëm pa mediat si promotorë.

Mediat kanë fuqinë e ndikimit politik

* Në vitet e 60-ta të shekullit XX-të, ishte beteja elektorale Kenedi-Nikson në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sikur kjo fushatë të ishte zhvilluar në radio, betejën do ta kishte fituar Niksoni, falë përvojës së tij që kishte në politikë. Ai ishte gjithashtu, njeriu i cili bëri ndryshime në politikën amerikane. Por këta dy kandidatë, vendosën që të ballafaqoheshin në television, dhe publiku u emocionua shumë nga sharmi i të riut Gjon Kenedi, që pretendonte ta fitojë betejën. Dhe Gjoni e fitoi betejën: u bë president i Shteteve të Bashkuara. Ishte paraqitja e tij vizive në media, pra në television ajo që Kenedit i dha një përparësi të madhe për t’u zgjedhur president.



* Së dyti, edhe sot kujtohet urdhëri për mobilizim në UÇK, i lëshuar nga Shtabi i Pergjithshëm më 31 mars 1999. Opinioni publik u njoh me këtë urdhër përmes televizionit shqiptar TVSH-së, në programin satelitor. Përgjigja ishte mjaft masive, sidomos nga vendet e Evropës Perëndimore dhe SHBA-së. Është fjala për vullnetarët nga diaspora, të cilët u mobilizuan vullnetarisht në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pamjet filmike të trageteve me vullnetarë në Durrës, ishin frymëzimi i mijëra shqiptarëve dhe sidomos të rinjëve në diasporë për t'u mobilizuar në këtë luftë. Pra, mundemi të themi se roli i mediave në këtë rast ka ndikuar pozitivisht dhe ka patur efekt të dukshëm tek opinioni publik.

* Nëse nuk do të kishin qenë pamjet televizive, të cilat krijuan dhe bartën deri tek opinioni imazhin real të dhunës dhe të masakrave serbe në Kosovë, bota demokratike nuk do ta kishte mbështetjen e popujve të tyre për të marrë vendimin historik për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë. Qytetërimi euroamerikan dhe ai botëror, u trondit pikërisht nga pamjet e ekranit të vogël, ku çdo ditë paraqitej fatkeqësia e një populli në zhdukje e në vuajtje, (popullit shqiptar i Kosovës) nga ana e një shteti të dhunshëm, të egër e fashist (shtetit serb). Prandaj, në shumicën dërmuese të vendeve pjesëmarrëse në bombardimet e NATO-s kundër Serbisë, qytetarët në shumicë absolute i kishin mbështetur këto sulme. Duke njohur faktin se vendet demokratike nuk mund të veprojnë në kundërshtim me vullnetin e popujve të tyre, duhet thënë se kjo përkrahje që siguroi media ishte vendimtare në marrjen e vendimit politiko-ushtarak për ta ndaluar makinën ushtarake serbe në përpjekjet e saj për ta asgjësuar popullin shqiptar të Kosovës.

Sic edhe u ilustrua, roli i mediave nuk mund të mohohet. Madje, ne as që mund ta mendojmë një jetë pa to. Errësira informative që do të vinte në mungesë të mediave, do të ishte verbuese. Por, edhe pse kanë rëndësi jetike, mediat nuk janë gjithmonë të mira. Apo, të paktën, nuk përdoren gjithmonë si duhet. Së këndejmi, duhet të tregohen edhe anët e "errëta" të mediave.

Efektet negative të mediave

Dhuna dhe agresiviteti

Ekspozimi i publikut ndaj përmbajtjeve mediatike me dhunë dhe agresivitet nxit sjellje të tilla në jetën e përditshme, sidomos te fëmijët. Filmata, lojërat elektronike, përmbajtjet në internet, madje edhe muzika vazhdimisht kultivojnë dhunë.

Në vitin 2011, një 21 vjeçar vrau në aeroportin e Frankfurtit dy ushtarë amerikanë, që do të udhëtonin për në Afganistan. Pas kryerjes së krimit, ai kishte thënë se ishte nxitur për një akt të tillë pasi ka parë në internet një video, ku disa ushtarë amerikanë gjatë plaçkitjes së një shtëpie në Afganistan përdhunonin një vajzë.

Pra, dhuna në media është aq e përhapur sa që audiencia e merr atë si mënyrë normale për zgjidhjen e problemeve dhe bëhet immune karshi dhunës reale.


Gerbner thotë se ekspozimi i vazhdueshëm ndaj dhunës në media mund të ngjallë frikë te njerëzit duke i bërë të besojnë se dhuna është e kudondodhur. Këtë dukuri ai e quan “Sindroma e Botës së Ligë”.

Dallimi mes botes reale dhe imagjinare

Kur fëmijët e vegjël dalin para pasqyrës e kuptojnë në moment që nuk fluturojnë dot sikur Supermani. Ata, sikur kthehen në realitetin e mjegulltë, mes botës reale dhe asaj imagjinare. Po përmendim fëmijët, pasi pikërisht ajo konsiderohet moshë në të cilën, secili përballet me dilemën se, a ekzistojnë vërtetë superheronjtë, shtrigat, vampirët dhe shumë personazhe tjera filmike që përcjellin një periudhë të rëndësishme të secilit individ drejt krijimit të personalitetit.

Një problem i tillë trajtohet shumë arsyeshëm në filmin “Ben X“, drama belgo-holandeze e cila portretizon jetën e një adoleshenti dhe problemet e tij në realitetin e përditshëm të cilat e dërgojnë drejt një jetese në botën virtuale, prej ku çdo ditë e më shumë fillon të ngaterrojë jetesën mes këtyre dy formave. Përzgjedhja e karaktereve në video-lojëra është mënyra e tij e vetme se si Beni shpreh brendësinë dhe shfaq kreativitetin e karakterit të tij. Bota virtuale zgjon kureshtje të madhe dhe çdo herë e më shumë ka tendencë të marrë primatin kundrejt realitetit.

Bisedat nëpër rrjete sociale për një pjesë të madhe të përdoruesve dalin të jenë më atraktive sesa diskutimet e drejtpërdrejta. Mënyra e vetme e cila e mban publikun një hap larg drejt konfuzionit se çfarë po ndodh në botën reale dhe çfarë i përket virtuale, është krahasimi se cila prej ngjarjeve ka mundësi të ndodh në realitet.



Imitimi

Zhvillimi i mediave, formën e të cilit ne sot po e jetojmë, nuk ka pasur vetëm pasoja pozitive. Mediat i kanë akuzuar se e kanë përmbatur publikun në një rrjedhë informacionesh, njoftimesh e kometesh, që në të vërtetë e pengojnë të ketë kohë për të gjykuar. Pastaj afrimi i propagandës me reklamën, afrim ky që mbështetet në njëjtësinë e mjeteve, sepse në shumë vende të botës metodat e bindjes politike kanë huazuar shumë prej teknikave të propagandës: u drejtohen parullave, pamjeve të markës. **Domenach** thotë se po bëhet gjithnjë e më vështirë të dallohet propaganda politike prej informacionit. Disa sociologë i kanë dënuar mediat si mjete të manipulimit të qytetarit, ngaqë informacioni nganjëherë e ka burimin prej një grupi ose institucioni politik dhe mund të krijohen dyshime lidhur me vërtetësinë e tezave dhe lajmeve që përpiqet të përhapë.

A manipulojnë me pavetëdijen tonë mediat? Po! Si reklamat ashtu edhe propaganda janë bërë makina të fuqishme për t'u mbushur mendjen turmave. Reklamat përdorin metoda psikanalitike për të orientuar “dëshirat” e opinionit dhe blerjet. Fushatat për reklamim mbështeten kryesisht te konfliktet e brendshme dhe ankthet e fshehta të publikut, dhe jo aq në cilësinë e produkteve. Frigoriferi bëhet ishulli i sigurisë së ngrirë, fabrikantët e kozmetikave shesin shpresën, tregtarët e lëngjeve të frutave shesin forcën jetike. Kështu secili industrialist përcakton “karremin psikologjik” që ua siguron klientët.

Kur shohim se mediat përveç që mund të ndikojnë pozitivisht, ato ndikojnë shtuar edhe negativisht, duhet të sqarohen dy çështje që na sjellin në këtë situatë – të mosdefinimit të një ideje të përdorimit të mediave.

“Edukimi medial” për ligjë brishtësinë e shkencave humane

Në korrikulat e arsimit parauniversitar të vitit shkollor 2016/17 në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë planifikon futjen e lëndës “Edukim Medial” si lëndë zgjedhore.

Tre vjet më parë nga Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK) u nxit një debat për këtë temë, ku cilësoi se futja e një lënde për njohjen e mediave në shkolla fillore dhe të mesme është e domosdoshme, e gjithë kjo mbi arsyetimin se kjo do t'i ndihmonte nxënësit për një njohjen e efekteve pozitive dhe negative të medie, pra të dijnë të filtrojnë përmbajtjen mediale që i'u servohet. Edhe nga ekspertë të medie si profesorë universitar dhe të shkollave të mesme dhe Qendra e Medie të Grave cilësojnë si të domosdoshme futjen e kësaj lënde në sistemin arsimor parauniversitar. Në kordinim me këto grupe MASHT-ti morri vendim se pas rishikimit të dokumenteve kurrikulare, lënda “Edukimi për Medie” do të përfshihet në Kornizën e Kurrikulës së arsimit parauniversitar të Kosovës si çështje ndërkurrikulare për të gjitha fushat kurrikulare.

Është i drejtë ky shqetësim dhe dukshëm shihet nevoja për këtë lëndë, por në anën tjetër kjo nevojë nxjerr në pah edhe një problematik që lidhet me përfitimin që kanë nxënësit nga

lëndët humane si; Gjuha, Filozofia, Sociologjia, Etika, Logjika, Historia, Edukata Qytetare. Në suazat e përgjithshme të përkufizimit të medias dhe perspektivës kulturaliste, mund të themi se media ekziston me bashkëveprimet mbi këto fusha - të cilat mësohen si lëndë në shkollat tona. Media si e tillë është zhvilluar kryesisht nën ndikimin të gjuhës, filozofisë, letërsisë, etikës etj, - pra kryesisht të shkencave humane dhe nuk mund ta shohim si të shkëputur nga to. Modelet, funksionet, kontrollat që ushtrohet mbi to dhe funksionimi i përgjithshëm i tyre është i krijuar mbi këto premisa.

Duke e parë këtë ndërlidhje të medias me shkencat humane dhe në anën tjetër hapësirën e këtyre shkencave në sistemin tonë arsimor, mund të pritej që individi i cili del nga një proces arsimor 12/13 vjeçar të jetë i aftë së paku minimalisht të filtrojë përmbajtjen mediale që ju servohet. Mirëpo, duket se kjo nuk po ndodh brenda sistemit tonë arsimor që nëpër mjet këtyre lëndëve të aftësoj nxënësit të dalloj tendencat manipuluese dhe kornizuese të medieeve.



Këtë konkludim mund ta bazojmë edhe tek cilësimet e këtyre ekspertëve, grupeve dhe vendimit të Ministrisë së Arsimit, që kjo lëndë të jetë pjesë e sistemit arsimor, pra, në një farë trajte është ‘konfirmuar’ mos efikasiteti i lëndëve të lartë cekura sepse të kuptuarit dhe të gjykuarit mediat nuk ilustron vetëm me lëndë specifike të fushës së mediave dhe komunikimit, por edhe më gjërë.

Trajtimi që u bëhet shkencave sociale brenda sistemit arsimor parauniversitar në vend tregon nevojën për rimodelim të planprogramit të tyre me tendencë që ato të jenë më të kapshme për nxënësit, të janë ndikues në formimin e personalitetit të tyre. Në këtë rrafsh orientimi i këtij arsimi aktual nuk ka arritur që përmes disiplinave sociale, nxënësit të dinë të zotërojnë qenësorën e të mësuarit kritik mbi nocionet e mediave dhe kjo pastaj e bënë edhe më urgjente futjen e edukimit medial në shkolla fillore dhe ato të mesme.

Futja e edukimi medial si lëndë është shumë i rëndësishëm, por vetëm si i tillë nuk i “mbron” adoleshentët nga media nese natyra e kësaj lënde nuk funksionon përtej të mësuarit mbi strukturën e tërsishme, rrjedhimisht më përtej formës sic janë mësuar shkencat humane.

Iluzioni për privatësinë

Mendon qe të dhënat e tua janë të sigurta edhe atëherë kur ke zgjedhur opsionin “Only me” tek Privacy? Unë të këshilloj të dyshosh. Më tepër se 30 milion përdoruesit e AshleyMadison.com menduan njëlloj sikurse ti, deri atëherë kur hakerët kanë ekspozuar emrat e tyre, adresat dhe pagesat me kartelë krediti për të gjithë përdoruesit e këtij rrjeti social.

A të ka ndodhur ndonjëherë që makinat e kërkimit të njohin atë çka dëshiron ti të kërkosh kur ende s’i ke shkruar tri shkronjat e para? Atëherë, diku duhet të ekzistojë një bazë e të dhënave që merr dhe mbanë të dhënat e tua.

Në epokën në të cilën po jetojmë, privatësia është njëra ndër gjërat më vështirë të kontrollueshme. E, kjo po i prekë më së shumti ata të cilët ende nuk janë të vetëdijshëm për dëmin që po iu shkaktohet. Të dhënat tua janë një ushqim i domosdoshëm për miliona kompani marketingu në mbarë botën. Pra, kujdes kur ngarkoni informacione në rrjete sociale dhe media tjera.



Në një studim të bërë në Britani vetëm 7% e personave kanë deklaruar se lexojnë “Termet dhe kushtet e përdorimit” (Terms and condition), kur dëshirojnë të blejnë apo t’i qasen një produkti online. Kjo bënë që ata si pasojë e përtesës t’ia falin të dhënat e tyre dikujt, me qëllim që të marrin diçka tjetër. Nuk është asgjë tjetër, përpos tregti që i shërben shumë kompanive të ndryshme të marketingut në mbarë boten.

Të rinjtë janë ata që më së paku janë të vetëdijshëm për privatësinë tyre dhe të të dhënave të tyre. Sipas hulumtimeve të bëra nga internetsafety.org thuhet se një i ri mesatarisht ka 300 shokë në llogarinë e tij në Facebook; dhe 40% prej tyre e kanë publik profilin në rrjetet sociale. Madje, shumë nga ta nuk e dinë as definicionin për privatësinë.

Në përgjithësi, privatësia definohet si e drejta për të qenë i lirë nga vëzhgimi i fshehtë dhe të përcaktosh personalisht se kur, si dhe kujt, t’ia zbulosh një informatë personale ose organizative. Mirëpo, a është kjo vetëshkelje e privatësisë? A po shkelim vetë privatësinë tonë duke ia dhënë pavetëdijshëm të tjerëve informatat që na takojnë vetëm neve? Me gjasë, po.

Privatësia është problem global e shembull i tillë është ish-kontraktori teknik amerikan Edëard Snoëden, i cili në qershor 2013 zbuloi në media materiale sekrete të SHBA dhe Britanisë së madhe në lidhje me programet e tyre përgjuese të civilëve në mbarë botën. Me këtë u krijua problematika botërore e shkeljes së privatësisë. Atë së cilat të dhëna do duhej të publikohen e cilat jo.

Përballë këtij vrulli të informacioneve, kur të dhënat janë ushqimi më i shtrenjtë në raftet e dyqaneve, do duhej të krijoheshin më shumë mekanizma mbrojtjes, kryesisht përmes informimit, që të rinjtë të mos bëhen pjesë e donatorëve të privatësisë vetjake, pa e kuptuar fare rëndësinë e saj.


Kur gjendemi në një situatë të tillë, kur mediat keqpërdoren dhe kur kemi të bëjmë me një vetëdije të tillë për rrezikun që mund të kanosë media, më poshtë synohet të tregohet se si të mbrohemi nga media; e gjithashtu, si të edukohemi që të mbrohemi nga keqpërdoruesit e mediave.

Si të ruhem nga mediat?

Çdo ditë ne u ekspozohemi qindra, madje mijërave imazheve, që kur zgjohemi, e derisa na zë gjumi. Pikërisht për këtë, të rinjtë e sotëm njihen si *mosha të ekraneve*. Por, pamjet që na ofrohen, jo gjithmonë janë të duhurat, prandaj edhe duhet të jemi të vetëdijshëm për mënyrën se si u qasemi imazheve dhe ideve që marrim nga mediat. Një gjë e tillë ka ndikuar që edukimi medial të shndërrohet në domosdoshmëri, meqë qëllim kryesor i tij është që njerëzit të bëhen kritikë ndaj përmbajtjeve të mediave.

Kur marrim një mesazh nga mediat, duhet të kemi parasysh disa fakte, si:

- Të gjitha mesazhet e mediave janë të ‘ndërtuara’ nga një apo më shumë individë, të cilët bashkë me mesazhin, na ofrojnë edhe mënyrën e tyre të interpretimit, e cila bëhet ‘pasqyrë’ e realitetit për të gjithë. Prandaj, duhet të jemi kritik ndaj interpretimeve të mediave.
- Mediat përdorin çdo mënyrë të mundshme për të pasur ndikim. Për shembull, titujt e theksuar bëhen me qëllim të paraqitjes së një ngjarjeje si më të rëndësishme. Por, ne duhet të masim interesin publik në një mesazh, pasi që nëse diçka është e rëndësishme për mediat, nuk është domosdoshmërisht edhe për ne.
- Mediat janë biznese që, primar e kanë fitim, jo interesin publik. Interesat e sponsorëve që proklamohen në media si të mirëqena, nuk janë të tilla, prandaj, nuk duhet t’u besojmë.
- Aftësinë për mendim kritik duhet ta instalojmë tek fëmijët, me të cilët duhet të bisedojmë për përmbajtjet e dhunshme që shohin, sepse kujdesi jo domosdoshmërisht nënkupton mbajtje larg nga pamje të tilla.
- Përmbajtjet e mediave ndikojnë që gjeneratat e reja të rriten me paragjykime ndaj kategorive të caktuara, që janë të lëndueshme, si fëmijët me sindrom doën, me autizëm, apo edhe komunitete të ndryshme si LGBTI. Pikërisht faktori që duhet t’i eliminojë paragjykimet e tilla, përkundrazi, vetëm se i nxit më shumë. Prandaj, mënyra më e mirë për të gjykuar drejtë, është të jesh i informuar, e ndërlihdja mes informimit dhe gjykimit të drejtë, përbën imunitetin më të qëndrueshëm ndaj manipulimeve të mediave.
- Nëse ju keni filluar të praktikoni qasjen kritike, atëherë për çdo mesazh që shihni në media, shtroni vetes këto pyetje:
 1. Kush e krijoi këtë mesazh dhe pse po e dërgon atë?
 2. Çfarë teknikash janë përdorur për të tërhequr vëmendjen time?
 3. Çfarë lloj vlere apo këndvështrimi përfaqësohet në këtë mesazh?
 4. Si mundën njerëz të ndryshëm ta kuptojnë këtë mesazh ndryshe nga unë?
 5. Çfarë është lënë jashtë nga ky mesazh?



Rëndësia e edukimit në parandalimin e keqpërdorimit të medias

Edukimi medial është procesi përmes të cilit njerëzit aftësohen që të kuptojnë natyrën e mediave, që ata të jenë në gjendje që jo vetëm të marrin informacione por edhe t'i analizojnë ato informata dhe të krijojnë një mendim vlerësues/gjykues për informatat e marra. Është e rëndësishme që të mësohet për mënyrën sesi krijohen ngjarjet dhe kush vendos se për çka “ne” do të diskutojmë ose mendojmë. P.sh nëse një ngjarjeje i jepet shumë rëndësi, ne detyrimisht do të mendojmë për atë ngjarje, dhe studimi i mediave do të na ndihmonte që të kemi aftësinë që të identifikojmë rastet kur ngjarjeve i jepet më shumë rëndësi se që e meritojnë, ose të kuptojmë pse ka raste kur disa ngjarjeve nuk iu jepet hapësirë fare.

Ne po jetojmë në një kohë kur mediat kanë arritur të depërtojnë në çdo cep të botës dhe jetës sonë, në këtë mënyrë mediat konsiderohen si burimi dhe transmetuesi kryesor i dijes, por jo vetëm. Nëse mediat krijojnë një ngjarje dhe i japin shumë rëndësi, atëherë njerëzit do të mendojnë se ajo ngjarje është e vërtetë, duke përgjithësuar se aty ku ka tym detyrimisht do të ketë edhe zjarr, e kështu edhe ajo që s'është e vërtetë merret si e tillë. Kjo ka bërë që të ketë nevojë që njerëzit të edukohen për mënyrën sesi funksionojnë mediat dhe si ato mund të manipulojnë me audiencën për qëllime të ndryshme. Në mënyrë që të dijmë të bëjmë pyetjet e duhura dhe të kërkojmë llogari nga mediat, duhet mësuar obligimet ligjore dhe morale të mediave, të mësojmë sesi funksionojnë ato dhe cili është qëllimi i vërtetë i një mediumi të caktuar.

Edukimi medial krijon një audiencë që jo vetëm është e mbrojtur nga manipulimet e mundshme mediatike por edhe krijon njerëz të informuar dhe të përgjegjshëm që dinë si t'i përdorin mediat dhe të ngrisin çështje të rëndësishme që do të përmirësonin jetën në komunitetin e tyre përmes mediave. Një shoqëri e cila është e edukuar dhe e vetëdijshme për ndikimin dhe qëllimet e medias është një shoqëri që është e pavarur dhe në gjendje të vendos se çka është e mirë për të e çka jo.

Pse na duhet edukimi medial?

Në tërë këtë vërshim të plasimit të informacioneve, deklaratave e përmbajtjeve të pakontrolluara, ekspozimi ndaj mediave e përgjithësisht mjeteve të tjera të komunikimit masiv siç janë: interneti, rrjetet sociale, muzika, filmi etj, është bërë i pashmangshëm, por me rrezikshmëri të lartë të ndikimit që këto përmbajtje kanë te audiencia. Mediat të cilat cilësohen si pushteti i katërt në shoqëri, si ndërmjetës të informimit në mes pushtetit dhe audiencës, para së gjithash janë industri informacionesh të cilat përcaktojnë se çfarë përmbajtje të adresojnë te publiku. Kështu, mediat jo rrallë herë arrijnë të manipulojnë në raportime, përcaktojnë interesin publik dhe hapësirën publike për qytetarët.

Mediat fillimisht themelohen për qëllime profitabile personale. Vetë përzgjedhja e informacioneve nga ana e mediave, tregon subjektivitet dhe kështu ato përcaktojnë se çfarë është në interes të publikut. Kjo ndodhë për arsye se mediat në shumicën e rasteve kontrollohen nga pushtetasit apo grupe të caktuara biznesore, dhe në këtë formë atyre u

mungon liria mediale për të respektuar rregullat profesionale në raportim. Kësisoj audiencia duhet të jetë e përgatitur të arrijë t'i dallojë përmbajtjet që janë në interes të tyre.

Pjesëmarrja publike e qytetarëve e krijon hapësirën publike, e cila funksionon më efektshëm në shoqëritë ku ajo është e pavarur nga shteti dhe forcat ekonomike të shoqërisë me ndihmën e mediave, pasi ato u mundësojnë qytetarëve të shprehin qëndrimet e tyre për ngjarje që preokupojnë jetesën e tyre. Qytetarët me edukim medial dhe me zë aktiv në shoqëri demokratike duhet të dijnë si të shfrytësojnë këtë hapësirë dhe të mos bie pre e manipulimeve. Kur jemi te aspekti fizik i përdorimit të mjeteve të komunikimit masiv, sipas statistikave të viteve të fundit është konstatuar shpejtësi marramendëse e informacionit duke përfshirë 2 miliardë shfrytëzues të internetit (2/3 e popullsisë në botë), të cilët marrin dhe dërgojnë 300 miliardë mesazhe elektronike çdo ditë.

Në mënyrë që të luftohet ndikimi i qëllimshëm i përmbajtjeve mediatike, njerëzit duhet të kenë edukim se si t'iu çasen mediave, të dijnë për efektet negative dhe pozitive që i ka media dhe të mos i marrin mesazhet si të mirëqena. Nga të gjitha statistikat e ndikimit të medias, informacioneve të pakonfirmuara, realitetit të konstruktuar, varësisë virtuale dhe pasi që mediat janë industri që nuk mund të kontrollohen aq lehtë, është i domosdoshëm edukimi medial në shoqëri.



Në cilin cikël duhet të fillohet të mësohet edukimi medial?

Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet arsimore në Kosovë po ndryshojnë dita-ditës. Mësimi “klasik” po i vie fundi. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë ka bërë që nxënësit sot të kalojnë më shumë kohë në ekspozimin ndaj informacioneve mediale, sesa ndaj informacioneve që marrin në shkollë. Për këtë ka lindur edhe nevoja e përfshirjes së edukimit medial në shkolla, nevoja që nxënësit në shkolla të mësojnë se si t’i përdorin mediat, si ta përceptojnë mesazhin me një pregaditje, si t’i vlerësojnë informacionet që i marrin nga mediat. Me një fjalë si të funksionojnë në këtë botë me plotë mesazhe për media. Sot mesatarisht secili në botë i ekspozohet 300 – 5000 mesazhe në ditë. Këto mesazhe kërkojnë që të jesh i përgaditur që t’i kuptosh, në mënyrë që ta kesh vetveten në kontroll dhe jo media të të ketë ty. E kush më mirë sesa edukimi medial mund ta arrijë këtë?

Futja e edukimit medial si lëndë në arsimin parauniversitar duhet të ndodh sa më shpejt. Nxënësit e shkollave të mesme duhet të mësojnë për efektet pozitive dhe negative të mediave, si të vlerësojnë kuptimin e mesazheve mediatike, mos t’i marrin ato si të mirëqena, por t’i analizojnë ato me një sy kritik, pasi që mediat konstruktojnë realitet, nuk transmetojnë as nuk pasqyrojnë atë. Nxënësit duhet të dinë të vlerësojnë përmbajtjet reale dhe joreale të medias. E mira e edukimit medial është se na shpëton nga të qenit analfabet funksional. E analfabetizmi funksional nënkupton ata persona që din të shkruajnë dhe lexojnë, por nuk e kuptojnë mesazhin që u jipet. Këtu hynë edhe shpëtimi nga të qenit analfabet medial, apo nga mosdija e përdorimit të mediave.

Në botë ka rreth 2 miliard shfrytëzues të internetit (rreth një e treta e popullsisë në botë), dhe ata marrin e dërgojnë 300 miliardë mesazhe elektronike çdo ditë. Të kuptuarit e këtyre mesazheve është e rëndësishme. Nëse një mesazh i caktuar nuk arrihet të kuptohet drejt nga të rinjtë, ai mund të qoj drejt dukurive negative, madje edhe drejt vrasjeve. Në një hulumtim që ka bërë “Nees21”, thuhet se numri i fëmijëve dhe adoleshentëve 19-vjeçar të vrarë me armë në SHBA mes vitit 2002-2012 ka qenë të paktën 28.000. Sipas tyre, adoleshentët në mes moshave 15 dhe 19 përbëjnë më shumë se dy të tretat e të gjitha vdekjeve me armë të të rinjëve në SHBA. Edhe shteti i Marylandit nuk mbetet mirë në këtë aspekt. Ky shtet nga viti 2002-2012 kishte një nga përqindjet më të larta të vdekjeve me armë të të zinjëve. Në 11 vitet e fundit, më shumë se 600 fëmijë të zinjë u qëlluan dhe u vranë në shtëpitë e tyre apo në rrugë. Një nga arsyet e gjithë këtyre vrasjeve është edhe agresiviteti i të rinjëve. Ekspozimi ndaj një numri të madh të mesazheve apo pamjeve të ndryshme dhe mosdija e kuptimit të atyre mesazheve rritë mundësinë e agresivitetit tek të rinjtë. Kështu që, rëndësia e përfshirjes së edukimit medial në arsimin parauniversitar, del të jetë e madhe. Arsimi parauniversitar është cikli më i përshtatshëm nga ku duhet të fillojë edukimi medial, sepse mosha e nxënësve në këtë cikël është më e gatshme të vlerësojë rëndësinë që kanë mediat. Kosova duhet të ndjek praktikën e vendeve tjera sa i përket futjes së edukimit medial në shkolla. Në shkollat e mesme në Finlandë arsimi për media u prezantua në vitin 1977. Mirëpo, arsimi për media që ne e njohim sot nuk u zhvillua në Finlandë deri në vitet e 90-ta. Edukimi medial ka qenë i

detyrueshëm edhe në vendet tjera. Në Danimarkë nga viti 1970, ndërsa, në Suedi nga viti 1980. Zhvillimi i tij në këto dy vende ka qenë në vitet e 80-ta dhe 90-ta.

Nxënësit e arsimit parauniversitar janë ata që më së shumti i përdorin mediat dhe që më së shumti kanë nevojë për një edukim medial. Ndërsa, edukimi medial në shkollat fillore nuk është se është i dëmshëm, përkundrazi është i mirëseardhur edhe në këtë cikël, vetëm se fëmijët e shkollave fillore e kanë më të vështirë të kuptojnë fushën mediale.

Sidoqoftë, në cilin do cikël që do të futej edukimi medial do të ishte një lloj “eksperimenti” për krijimin e mendimit kritik të shoqërisë kosovare.

Pra, thënë në pika shumë të shkurta, mediat sa ndikojnë në aspektin pozitiv, dijnë të jenë edhe të errëta. Për këtë, roli i edukimit medial nuk duhet mohuar, por duhet t'i jipet hapësira që i takon, si një mburojë nga keqpërdoruesit e medias.



*Kjo shtojcë, është prodhim i studentëve të gazetarisë në Universitetin e Prishtinës.
